



Ne baze të nenit 12, paragrafi 2, shkronja (d), lidhur me nenin 17, 24 dhe 40 të Ligjit, Nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008”, e në mbështetje të nenit 15, lidhur me nenin 27, 28 dhe 29, pika 2, të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008 dhe në zbatim të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 01-Nr-16-586, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren për ndryshim plotësimin e Rregullores për ndarjen e subvencioneve 01-Nr-110-47552, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datën, ----- miraton këtë:

Projekt-V E N D I M

Neni 1

Me këtë vendim miratohet kërkesa 01-Nr-181-30362 e datës 31.05.2024 e parashtruar nga Arben Bytyqi nga fshati Nishor Komuna e Suharekës, për ti ndihmuar në renovimin e shtëpisë, pasi që me datën 26.05.2024 i është djegur kulmi dhe i është dëmtuar pllaka me muret anësore të shtëpisë nga fatkeqësia natyrore e goditur nga rrufeja.

Neni 2

2.1 I ndahen mjete financiare në shumë prej: **5,000.00€ (pesë mijë euro)**.

2.2 Mjetet financiare në shumë prej **2,500.00€**, për ti ndihmuar në ndërtimin e shtëpisë do të paguhet nga buxheti i Komunës, nga kategoria ekonomike e subvencioneve, kodi i programit 21/624/85012/22202/00000/0820 të planifikuar në Drejtorinë për kulturë, rini, sport dhe mërgatë (pagesa për transferet për përfitues individual tjerë).

2.3 Mjetet financiare në shumë prej **2,500.00€**, për ti ndihmuar në ndërtimin e shtëpisë do të paguhet nga buxheti i Komunës, nga kategoria ekonomike e subvencioneve, kodi i programit 21/624/47012/22202/00000/0421 të planifikuar në Drejtorinë për bujqësi dhe zhvillim rural (pagesa për transferet për përfitues individual tjerë).

2.4 Mjetet financiare do të lëshohen në xhirollogarinë e Arben Bytyqi-t nga fshati Nishor Komuna e Suharekës.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës, Drejtoria për kulturë, rini, sport dhe mërgatë dhe Drejtoria për bujqësi dhe zhvillim rural në bashkëpunim me Drejtorin për ekonomi, financa dhe buxhet të Komunës së Suharekës.

Neni 4

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008” dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimit e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr-_____
Me datë_____

Kryesuesi i Kuvendit

Mr.ec Bexhet KUÇI